



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1429/1 Prot.

Tiranë, më 28.05 2024

V E N D I M

Nr. 34 dt. 28.05 2024

**“PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË FORMËN E CERTIFIKATËS PËR PROGRAMIN
E STUDIMIT TË FORMIMIT TË VAZHDUAR NË FUSHËN PSIKO-PEDAGOGJIKE”**

Mbështetur në nenin 37, 38 , 81, 91 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në Udhëzimin nr.10 datë 30.03.2020 të MAS “Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga IAL dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor”, i ndryshuar, në nenin 19, 20, 81 të Statutit të UST-së, në nenin 7 të Rregullores së UST-së, në shkresën nr.723/3 prot., datë 24.04.2024 “Kërkesë për miratimin e ndryshimeve në formën e certifikatës për “Programin e studimit të formimit të vazhduar në fushën Psiko-Pedagogjike” të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, Senati Akademik në mbledhjen e datës 28.05.2024,

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimeve në formën e certifikatës për programin e studimit të formimit të vazhduar në fushën Psiko-Pedagogjike, të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes (formati bashkëlidhur).
2. Vendimi së bashku me dokumentacionin shoqërues përcillet për regjistrim në QSHA.
3. Ky Vendim t’i përcillet për njohje dhe zbatim Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes si dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORATI

Nr. 1253/ Prot.

Tiranë, më 02.05 2024

V E N D I M

Nr. 31 dt. 02.05 2024

**“PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË FORMËN E CERTIFIKATËS PËR PROGRAMIN
E STUDIMIT TË FORMIMIT TË VAZHDUAR NË FUSHËN PSIKO-PEDAGOGJIKE”**

Mbështetur në nenin 40, 81, 91 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në Udhëzimin nr.10 datë 30.03.2020 të MAS “Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga IAL dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor”, i ndryshuar, në nenin 25, 81 të Statutit të UST-së, në nenin 11 të Rregullores së UST-së, në shkresën nr.723/3 prot., datë 24.04.2024 “Kërkesë për miratimin e ndryshimeve në formën e certifikatës për “Programin e studimit të formimit të vazhduar në fushën Psiko-Pedagogjike” të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, Rektorati në mbledhjen e datës 02.05.2024,

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimeve në formën e certifikatës për programin e studimit të formimit të vazhduar në fushën Psiko-Pedagogjike, të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes (formati bashkëlidhur).
2. Ky vendim t’i përcillet për miratim Senatit Akademik të UST-së.

REKTORI
Prof. Dr. Agron KASA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES
DEKANATI

Nr. 729/ Prot.
13

Tiranë, më 24.04.....2024

Lënda: Kërkesë për miratimin të ndryshimeve në formën e certifikatës për
"Programin e studimit të formimit të vazhduar në fushën Psiko-Pedagogjike"

REKTORIT TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS
PROF.DR. AGRON KASA

I nderuar Z. Rektor!

Në përgjigje të shkresës së ardhur nga QSHA me nr. 1342/1 prot, dt. 17.04.2024 "Kthim përgjigje" po ju përcjellim për miratim formën e certifikatës për "Programin e studimit të formimit të vazhduar në fushën Psiko-Pedagogjike" me ndryshimet e kërkuara nga QSHA.

Bashkëngjitur gjeni shkresën e ardhur nga QSHA si dhe formën e certifikatës së ndryshuar.

Faleminderit për bashkëpunimin.


Prof.Dr. Dhimitraq PRILETI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE ARSIMORE



Nr. 1342/ prot.

Tiranë, më 14.04.2024

Lënda: Kthim përgjigje.

UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS

(Adresa: Rruga "Muhamet Gjollesha", Tiranë)

Në përgjigje të shkresës Suaj nr. 723 prot., datë 5.3.2024, administruar në QSHA me nr. 1342 prot., datë 06.03.2024, në bazë të kreut III, pika 1, shkronja "a" të udhëzimit nr. 10, datë 30.03.2020 të Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë "Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës, ose certifikatës të lëshuar nga Institucionet e Arsimit të Lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor", i ndryshuar, e cila parashikon se: "Aplikimi për regjistrimin e formës së diplomës ose certifikatës kryhet në QShA i cili përmban kërkesën për regjistrim të rektorit të IALsë dhe dokumentacion shoqërues bashkëlidhur saj, si më poshtë: Kopje të statutit të miratuar në fuqi të IAL-së dhe aktit të miratimit, të cilit i bashkëngjitet edhe forma e miratuar nga Senati Akademik e diplomës, ose certifikatës dhe përmbajtja dhe forma e suplementit të saj për çdo cikël dhe lloj programi studimi", ju duhet të paraqisni urdhrat e Ministrit të Arsimit dhe Sportit me anë të të cilave është miratuar statuti i IAL-së dhe ndryshimet në statut.


Në formën e certifikatës, duhet të shtoni elementin "Numri unik i identifikimit", elementin "nr. i certifikatës", dhe elementin "Numri i diplomës së studimeve universitare të përfunduara më parë", si dhe të hiqni në pjesën fundore të formës shënimin "Kjo certifikatë shoqërohet nga lista e notave", dhe elementin "nr i regjistrimit".

Përsa më sipër, QSHA do të procedojë me regjistrimin e formës së certifikatës pasi të keni bërë plotësimet përkatëse në dokumentacion dhe në formën e certifikatës.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Aurora Balliu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVË TË LËVIZJES

CERTIFIKATË

E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË FORMIMIT TË VAZHDUAR NË FUSHËN PSIKO – PEDAGOGJIKE

I jepet

Z/Znj: _____, lindur në _____, datë; _____
(emri, atësisë, mbiemri) (vend) (data, muaji, viti)

në përfundim të Programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën Psiko – Pedagogjike, me kohë të plotë,
1 (një) semester, 35 kredite (ECTS), niveli i 7-të, referuar Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Përfundoi studimet në datë; _____.

Nr. i diplomës së studimeve universitare të përfunduara më parë; _____.

Data e lëshimit të certifikatës; _____.

Nr. unik i identifikimit; _____.

Nr. i certifikatës; _____.

D.E.K.A.N.I
PROF. DR. DHIMITRAQ PRIFTI

REKTORI
PROF. DR. AGRON KASA